

Program orientues për aktivitete në shtëpi

Si të punoj me fëmijën tim

Periudha që po jetojmë dhe situata në të cilën ndodhemi nuk është aspak e volitshme për asnjërin nga ne , duke na bërë që të kemi pikëpyetje si : “Sa do të zgjasë kjo situata?” , “Si do ta kaloj në mënyrë efektive kohën në shtëpi?” , “Si të përballoj stresin tim dhe të familjarëve të mi në këtë izolim?” , “A do të kem të ardhura të mjaftueshme për të përballuar këtë situatë në të cilën nuk arrij të punoj?” , “A do të kthehem ndonjëherë rutines?” , “Pasi të dalim nga karantina a do të jenë njëloj të gjitha gjërat apo do të kenë ndryshuar?” , “Fëmija im ka nevojë të vecanta si të arrij të menaxhoj sjelljet e tij dhe ta kthej në produktive kohën në shtëpi me të?” “ Cfarë aktivitete duhet të zhvilloj me fëmijën tim?” etj.

Duke u nisur nga nevojat e ndryshme që cdonjëri nga fëmijët ka dhe nga nevojat që prindërit kanë për të gjetur një rrugë në këtë situatë , e pamë të nevojshme që të bënim një udhëzues praktik për të punuar me fëmijët në kushte shtëpie.

- 1. Tavolina dhe grafiku .** Gjatë kësaj kohe është shumë e rëndësishme që të bëni një kënd në shtëpinë tuaj ku të vendosni një tavolinë dhe dy karrige , në mënyrë që të jetë vendi për të kryer aktivitetet që kërkojnë pozicionim , me fëmijën tuaj. Merrni një kuti ku të vendosni të gjitha aktivitetet (lojra apo libra) në mënyrë që të jenë të dukshme për fëmijën tuaj . Uluni së bashku me fëmijën tuaj dhe bëni një grafik ku të vendosni aktivitetet e ditës që do të zhvillonit me të , në mënyrë që fëmija të jetë i përgatitur për aktivitetin që e pret , të dijë oraret e pushimit dhe të ngrënjes , në mënyrë që ti ofrojmë një rutinë të re nga ajo që ka pasur më përpara . Grafiku duhet të jetë në bazë të zhvillimit të fëmijës , që do të thotë një fëmijë që akoma nuk lexon , grafikun do ta krijoni me vizatime të aktiviteteve që ai do të zhvillojë, në rastin kur fëmija lexon ato do të jenë të shkruara . Grafiku duhet gjithmonë të vendoset përpara fëmijës që ai ta shikojë atë dhe i kujtoni aktivitetin pasardhës në mënyrë që tranzicioni nga një aktivitet në tjetri të jetë më i kuptueshëm dhe më i lehtë për fëmijën tuaj . Gjithashtu grafiku çdo ditë duhet të ndryshojë rënditjen e tij prsh.nëse ditën e parë keni vendosur aktivitetin me kuba të parin , në ditën tjetër e zhvendosni të fundit si aktivitet , e bërë kjo në mënyrë që fëmija ta ketë më të lehtë tranzicionin nga dita në ditë.

DATA

EMRI: _____

KOHEZGATJA	AKTIVITETI
MENGJES	PËRDORIMI I TUALETIT
MENGJES	RREGULLIMI SHIRATIT
PËRFORCUESI	USHQIMI I PËRTERUA (BULA MË NUTELLA)
PARADITE	PLOTESIMI I NR 2
PARADITE	NGJYROSJA E FORMAVE
PËRFORCUES	MAKINA
PASDITE	AKTIVITET FIZIK (KËRCIM)
PASDITE	LOJE FUNKSIONALE (GATUARTE)
PËRFORCUES	30 MIN TELEVIZOR
DARKE	SHTRIMI TAVOLINGES
DARKE	Mbledhja e lotrave
PËRFORCUES	GUDULISJE

PËRFORCUES: 1. BULA MË NUTELLA 2. MAKINA 3. 30 MIN TV 4. GUDULISJE

<u>MUAJI</u>	<u>DIJA</u>
MARS	E SHTUNE
<u>DATA</u>	<u>STINA</u>
28	PRANVER

DIJE ME:

The illustration shows a sun on the left, a cloud in the middle with rain falling from it, and another sun on the right partially obscured by a cloud. Wavy lines represent rain falling from the clouds.

2. Përforcuesit ose shpërblimet . Gjatë kohës që punoni aktivitetet me fëmijët tuaj , është shumë i rëndësishëm përdorimi i shpërblimit apo përforcuesi . Përforcues mund të përdorni çdo gjë që fëmija juaj ka dëshirë duke filluar nga përforcimet me bazë ushqimore si : biskota , cokollata etj , perforcues fizikë si: dhënja e makines që i pëlqen apo lojes rrotulluese etj dhe përforcues social ku i thuhet “Bravo” , “Shumë mirë” , “Të lumtë” etj. Përforcuesi mndihmon që detyrat dhe aktivitet që i jipni fëmijës të kryhen më mirë pasi stimulohen në kryerjen e tyre. Sa më i vështirë që të jetë aktiviteti që i jipni aq më i fortë duhet të jetë përforcuesi për detyren. Në fillim përforcojmë detyra të thjeshta si prsh marrja e gotes së ujit në vendin ku ju i keni thënë , pasi fëmija kryen këtë veprim ju e shpërblemi me nje gjysmë biskote , më pas i jipni komanden që ta vendos atje ku e ka marrë goten , në kryerjen e këtij veprimi ju i jipni gjysmen tjetër të biskotes duke përforcuar pozitivisht një sjellje të tillë . Pasi mësohet një veprim i tillë gjysma e biskotes merret pasi fëmija i kryen të dyja veprimet njëri pas tjetrit nën komanden tuaj pa përforcues në mes , duke ja dhënë atë në fund të detyres. Kështu fëmija mësohet të kryej aktivitetet njëri pas tjetrit duke rritur nivelin e kuptushmërisë së komandave të dhëna , duke shtuar kohëzgjatjen e aktiviteteve dhe duke u stimuluar sa më gjatë për kryerjen e tyre që të marrë në fund shpërblimin e caktuar.



- 3. Televizori apo telefoni.** Duke qënë se ndodheni gjatë gjithë kohës në shtëpi është e vështirë që të mos ndezim televizorin apo të mos përdorim telefonin. Pavarishtë kësaj është shumë e rëndësishme fikja e tyre gjatë pjesës më të madhe të dites. Një dicka e tillë do të shkaktonte sjellje tek fëmija duke u fokusur vetëm në stacionet me muzik që mund të dëshirojë , përsëritjen e reklamave duke shtuar ekolalin(përsëritja e vazhdueshme e fjalëve) etj. Mundohuni sa më shumë të evitoni lajmet dhe ti dëgjoni ato pasi fëmija të ketë fjetur , kjo pasi emocionet tona dhe gjendja jo mire e jona percillet edhe tek fëmijët . Mundohuni që tëlëvizorin dhe telefonin në raste shumë të rralla ta jepni si një shpërblim prsh.pasi fëmija ka kryer të gjitha aktivitet e ditës të programuara mund tja ndezni televizorin jo me shume 30 min për të parë dicka që ai dëshiron.
- 4. Komunikimi.** Mundohuni që gjatë të gjithë kohës të komunikoni me fëmijën tuaj duke emërtuar cdo gjë që bëni . Mundohuni të përdorni fjalë të thjeshta dhe fjali të thjeshta për të përcuar sa me qarte mesazhin tuaj te fëmija. Mundohuni të flisni në mënyrë të shkoqur fjalët që të jenë sa më të kuptueshme për ta prsh.nese një fëmije I thuhet “Të lutem merre lapsin që ndodhet te tavolina sepse së bashku do të vizatojmë ariun” mundësia që fëmija të kuptojë mesazhin është e ulët , nese ne e ndryshojme kemi mundësi që fëmija ta kutojë dhe ta realizoj atë prsh.”Merre lapsin te tavolina “ “Vizatojmë ariun” etj.
- 5. Aktivitet fizik.** Në grafikun që do të hartoni vendosni edhe aktivitetin fizik . Aktiviteti fizik është shumë I rëndësishëm për shkarkimin e emocioneve si positive apo negative , minimizimin e sjelljeve steriotipike , shkarkimin e nivelit të stresit dhe të gjendjeve ankthioze . Ushtrimet fizike mund ti bëni me ushtrime të thjeshta aerobie , me kërcimin në top , me vendosjen e një bansi dhe imitimit të lëvizjeve etj. Krijoni një lojë e cila ka pengesa të thjeshta si shkapërcimi I një libri apo pelushi dhe më pas bërja e një gjuajtje

me top ose një ushtrimi aerobie . Në këtë mënyrë mund të arrijmë që të shkarkojmë dhe të mund të modelojmë dhe modifikojmë sjelljet që fëmija ka ose fiton gjatë qëndrimit në shtëpi.



- 6. Aktivitetet shtëpiake .** Kjo është periudha më e mirë që të angazhoni fëmijën tuaj në aktivitetet e përditshme shtëpiake . Ky aktivitet duhet të shënohet në grafikun e aktiviteve ditore me fëmijën tuaj . Duhet të kryeni detyra të tilla si : vendosja dhe palosja e rrobave në vendin e tyre, mund ta përdorni aktivitetin e rrobave për të diferencuar ngjyrat pra ndarjen e rrobave me ngjyra të ndryshme , shtrimi I tavolines së bashku ku gjatë kohes I tregohen orenditë e kuzhines, funksioni I tyre dhe vendosja e tyre në tavolinë , gatimi sëbashku ku I udhëzohet fëmijës që të sjell ushqimet që ju nëvojiten dhe gjatë të gjithë kohes I shpjegohet se cfarë po bëni , kategoria e ushqimeve që fëmija duhet të sjell prsh.domatja është perime, portokalli është frut etj , ngjyrat e tyre dhe shijet që kanë prsh.luleshtrydhet janë të ëmbla , limoni është I thartë etj. Aktivitet tjetër është ai I rregullimit të krevatit sëbashku ku edhe gjatë kësaj kohe I emërtohet jasteku , carcafët , batanija , jorgani etj. Aktivitete të tilla rrisin pavarësinë e fëmijës në kryerjen e detyrave shtëpiake dhe aktivizimin e tyre në mënyrë që të fitojmë sa më shumë sjellje pozitive.



7. Motorrika fine dhe globale. Një aspekt shumë i rëndësishëm për tu punuar dhe për tu vendosur në grafik është motorrika. Në kushtet e shtëpisë për motorriken mund të përdorni brumin duke krijuar dy ose tre aktivitete sëbashku prsh.mund të bëni biskota me fëmijën tuaj , gjatë këtij aktiviteti perfshijme disa aspekte e para marrim sëbashku me fëmijën të gjithë ingredientët të cilat na shërbejnë dhe vendosim fëmijen për ti thyer vezët , për të hedhur miellin dhe perzier ato. Pasi bëhet masa e dëshiruar e brumit një pjesë të saj ja japim fëmijës për të manipuluar me duar , për ta hapur atë , më pas së bashku mund të merrni format e ndryshme të kuzhinës duke i emërtuar ato dhe duke i bërë sëbashku me fëmijën vendosjen e formës mbi brumin . Mund të merrni rruaza të mëdha të cilat nuk ju shërbejnë më dhe me anë të një filli të filloni më fëmijën tuaj për ti përshkuar ato , aktivitetit mund edhe ti shtoni ndarjen dhe grupimin e rruazave me një ngjyrë të caktuar etj. Punimi me makarona apo fasule për të bërë format e ndryshme prsh.vizatoni në një fletë një trekëndësh ,një rreth , një katror etj dhe së bashku me fëmijen filloni të ngjisni makaronat apo kokrrat e fasules në fletën me format e vizatuara , më pas me ngjyra uji mgjyroseni ato sipër. Aktivitete te tilla ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e motorikes.





8. **Imitimi.** Në grafikun tuaj duhet të vendosen aktivitetet që lidhen me imitimin . Në kushtet e shtëpisë mund ta krijoni imitimin në aspekte të ndryshme prsh.të merrni kubat dhe të bëni nje formë të thjeshtë, më pas ti kërkoni fëmijës që të bëjë të njëjtën formë sikur ju. Në fillim bëjmë dy kuba dhe më pas shtojmë vështirësinë e aktivitetit. Mund të merrni objekte të njejta të përditshmërisë prsh.krëhër dhe të krihni me të flokët dhe ti kërkoni fëmijës që të bëjë të njëjtën gjë , furcen e dhëmbëv etj. Imitimin mund ta realizoni edhe nëpërmjet bansave , kërcimeve me 2 lëvizje dhe kërkoni që fëmija të imitojë lëvizjen që ju bëni . Mund të vendoseni përpara pasqyres dhe të bëni forma të ndryshme të mimikes dhe të kërkoni që fëmija të realizojë bashkë me ju imitimin e tyre.



- 9. Mbillni një lule.** Gjatë terapisë shumë aktivitete pasqyrohen dhe I tregohen fëmijes me anë të fotove sikurse është edhe mbjellja e një lulë . Në Kushte të shtëpisë ju keni mundësi që ta zhvilloni një aktivitet të tillë duke marrë një vazo dhe sëbashku me fëmijën tuaj ti hidhni dheun dhe ta vendosni lulen në të . Duke mos harruar që gjatë kohës që e bëni aktivitetin komunikoni dhe I shpjegoni fëmijës tuaj se çfarë po bëni . Një aktivitet të tillë e vendosni në grafik dhe 1 herë në dy ditë vendosni në grafik për ujitjen e lules , aktivitet që ju sëbashku me fëmijën tuaj duhet ta kryeni.



- 10. Vetëndihma.** Duke qënë se ndodheni gjatë gjithë kohës në shtëpi keni mundësi që të punoni me fëmijët në aspektet e vetëndihmës , prsh. nqs fëmija juaj vazhdon të ketë pampers mundohuni që gjatë kësaj periudhe të punoni në këtë aspekt duke e filluar për ta cuar në banjo cdo 30 min duke përdorur një përforcues të fuqishëm . Kryeni të gjitha veprimet sëbashku me fëmijën tuaj si ulja e rrobave , fshirja , shkarkimi ujit , larja e duarve , fshirja e tyre etj . Gjatë procesit të larjes mundohuni që ta udhëzoni fëmijën prsh duke I dhënë shampun duke e hedhur ne duar të fëmijës dhe duke e ndihmuar që të lajë flokët e ti . Nqs fëmija juaj nuk arrin që të vishet vetë punoni në këtë aspekt duke e ndihmuar ju fillimisht e më pas duke e orientuar me komand se çfarë të bëjë , të mbërthej the zbërthej kopsat , zingjirët , të veshë corapet , të lidhë dhe zgjidhë këpucët . Gjatë të gjithë aktiviteteve duhet të keni durim por në aktivitete të tilla duhet të mundoheni që të ruani qetësin pasi duhet të insistoni që fëmija juaj të fillojë ti kryej I pavarur procese të tilla sepse janë shumë të rëndësishme. Në këtë rast përdorni ilustrimet me foto të sekuencës së veprimeve prsh. vendosni mbi lavaman fotot e procesit të larjes së duarve etj.



Wash Your Hands



11. Loja funksionale. Përdorni të gjithë imagjinatën tuaj për të krijuar lojra funksionale prsh. merrni kubat dhe ndërtoni sëbashku me fëmijën tuaj një rrugë dhe më pas bësi sikur po zhvilloni gara me makina . Formoni shtëpia . Bëni fermen dhe vendosni kafshët e fërmës dhe së bashku me fëmijën tuaj bëni imitim e tyre . Krijoni xhunglen dhe vendosni kafshët duke diferencuar kështu kafshët e egra dhe të buta , të mëdha dhe të vogla , thoni ngjyrat e tyre etj . Merrni dy kuti dhe ndani perimet nga frutat dhe tregoni për karakteristikat e tyre etj . Merrni një kukull dhe filloni ta ushqeni duke përdorur orenditë e kuzhnës , duke imituar dhe duke thënë funksionin e gotës e luges etj . Formoni një puzzle dhe largoni një nga pjesët në mënyrë që të nxisni fëmijën tuaj që ta kërkojë atë etj . Fëmijët e arrijnë zhvillimin e tyre konjetiv nëpërmjet lojes dhe kjo është arsyeja që një fushë e tillë ka një gamë të gjërë aktiviteteve që mund të zhvilloni. Mos harroni që aktiviteti duhet të jetë I shkruar apo I vizatuar në grafikun që I paraqitet fëmijës.



12. Aktivitetet akademike. Një aspekt tjetër është ai akademik , në të cilin mund të zhvilloni një shumëllojshmëri aktivitete. Prsh . mund të merrni një fletë dhe në të vizatoni me pika format në mënyrë që fëmija juaj ti bashkojë ato . Të ngjyrosni me fëmijën tuaj ose ti jipni një model të ngjyrosur dhe ai ta bëjë njëloj . Të bëni shkonjat me pika, numrat , figura të ndryshme. Të merrni një objekt dhe ta shkruani atë me pika dhe fëmija juaj ta kopjojë . Të bëni bashkësi dhe të gjeni numrin e elementëve etj.



Dh
dh
Dhurata

E
e
Elefanti

F
f
Ëmbëlsira

F
f
Flutura

Figurat gjeometrike (Format 2D)

Ngjyros rrrathët me të njëjtën ngjyrë.

Ngjyros katrorët me një ngjyrë tjetër.

Ngjyros trekëndëshat me ngjyrë të ndryshme nga katrorët dhe rrrathët.

Krahët dhe këmbët janë **drejtëndorë**. Ngjyrosi me ngjyrë tjetër.

Të njohim numrin 2

Ngjyros 2 peshq.

2 2 2 2 2 2 2 2 2 2

Ngjyros 2 makina.

1

1 1 1 1 1 1 1 1 1 1

Figura të njëjta

Lidh figurat e njëjta.
Ngjyros format e njëjta me të njëjtën ngjyrë.

1

2

3

4

5

Lidh ato që janë dytë.

Shtro me X figurat e vendosura gabim.

Të njohim numrin 2



Ngjyros 2 peshq.

2 2 2 2 2 2 2 2 2 2

Ngjyros 2 makina.

36

TREKËNDORI DHE RRETHORI ... Ç're u mungon figurave? Lidh sipas formës dhe madhësisë.



Uroj që t'ju kemi ardhur në ndihmë me materialin e përgatitur , pavarësisht të gjitha udhëzimeve mos harroni ti përqafoni , e ti dhuroni shumë dashuri fëmijëve tuaj . Pas gjithë kësaj ne do të jemi aty edhe një herë për të ndihmuar në rifitim të aftësive.

Mund të na kontaktoni në cdo moment në adresat tona email ose në nr e tel.

megi.lazri@hotmail.com

0696276755

deakraja92@yahoo.com

0699423223

Urojmë që cdo gjë të kalojë sa më shpejt!

Msc.Megi Lazri Psikologe Terapiste ABA

Msc. Dea Kraja Logopede